



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:172212

Datë: 21.06.2024

Numri i dokumentit: 05846148

Ac.nr.3721/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Naim Mehulli - kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Liridon Maloku, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike-kontestimore të paditësve: Sh. e I.C.madhor, të miturit: L., L1., M., M1., dhe Sh.C të cilët i përfaqëson përfaqësuesi ligjor babai i tyre paditësi I.të gjitha nga fsh..., Komuna G...e të cilët sipas autorizimeve të gjithë paditësit i përfaqëson av.Shaqir Behrami nga Glllogovci kundër te paditurës Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike sh.a. (KEDS) Prishtine, për kompensimin e dëmit material dhe jomaterial, duke vendosur sipas ankesës së të së të autorizuarit të paditësve të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Glllogoc, C.nr.106/16, i datës 22.03.2021, në seancën jo publike, të mbajtur me datë 20.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e të autorizuarit të paditësve: Sh.C, I.C....., Lulzim C....., Lutfi C....., Medina C....., Murat C..... dhe Sh.C të gjitha nga fsh..., Komuna G....., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Glllogoc, C.nr.106/16, i datës 22.03.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.106/16, i datës 22.03.2021, në pikën ka vendosur si në vijim:

I.REFUZOHET SI E PA BAZUAR Kërkesëpadia e paditësve Sh., I., L., L1., M., M1., dhe Sh.C te gjitha nga fsh..., Komuna G...me të cilën kane kërkuar te **DETYROHET** e paditura Kompanija Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike sh.a. (KEDS) Prishtine, që paditësve për shkatë te humbjes se jetës të afërmit të tyre L2.I.C.i lindur me dt. 21.02.1998 me dt.15.09.2013 ne fsh..., Komuna G..... si pasoje e kontaktit me telin e large përçuesit përmes gypit te ujitjes, të ju paguaj paditësve në emër të **demit jomaterial** për shkak te dhimbjeve shpirtërore secilit paditës Sh., I., L., L1., M., M1., dhe Sh. te gjithëve veq e veq nga 5.000 euro, ndërsa **demin material** në emër te shpenzimeve te ngritjes se përmendores paditësit I.C.baba I te ndjerit L2.ti paguaj Shumen prej 2.000 euro dhe ne emër te shpenzimeve te varrimit Shumen prej 1.000 euro te gjitha ma kamate prej 8 % filluar nga data e paraqitjes se

padisë e deri ne pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës ne Shumen prej 7.694 euro, e nen kërcënimin e përmbarimit me dhune.

II. Secila pale I barte shpenzimet e veta te procedurës.

Kundër këtij aktgjykimi i autorizuari i paditësve në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e paditësve si e bazuar dhe aktgjykimi i atakuar të priset dhe çështja të kthehet në rigjykim.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur e paditura, me propozim që të refuzohet ankesa e paditësit ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e paditësve është e pabazuara

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit me datë 06.05.2016, në gjykatën e shkallës së parë kanë paraqitur padi për shpërblim dëmi, dhe të precizuar për gjat shqyrtimit gjyqësor, me të cilën ka kërkuar se për shkak se me dt.15.09.2013 ne fsh....., Komuna G.... familjari i tyre si pasoje e kontaktit me telin e largpërçuesit përmes gypit te ujitjes i cili në ato momente ishte duke i ujitur kulturat bujqësore ka humbur jetën i ndjeri L2.I.C.i lindur me dt.21.02.1998 ne fsh....., Komuna G..... I afërm i paditësve si pasoje e kontaktit, largpërçuesit kishin distancën nga toka në lartësi prej 5.20 m, kurse në kushte normalet duhet te jete ne distance prej 11 m., vdekja e të ndjerit është shkaktuar me fajin ekskluziv të paditurës, paditësit kane pësuar dem jo material për shkak të përjetimit te dhimbjeve shpirtërore dhe dëme material i cili konsiston në shpenzimet e varrimit dhe ngritjen e lapidarit, me kërkesëpadi paditësit kane kërkuar të detyrohet e paditura që në emër të zhdëmtimit jo material për shkak te dhimbjeve shpirtërore secilit paditës Sh., I., L., L1., M., M1., dhe Sh. të gjithë me mbiemër C..... të iu paguaj nga 5.000 euro, ndërsa në emër të shpenzimeve të ngritjes se përmendores paditësit I.C. baba I te ndjerit L.C2. paguaj Shumen prej 2.000 euro dhe në emër te shpenzimeve te varrimit Shumen prej 1.000 euro me kamata ligjore prej 8 % për derisa të paditurat e përmbushin detyrimin ndaj paditësve. Shpenzimet i ka kërkuar sipas tarifës.

Gjykata duke vepruar sipas padisë së paditësve pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të te gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.106/16, i datës 22.03.2021, me të cilën e ka refuzuar si e pa bazuar kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur më decidivishtë si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se: Nga Raporti I Stacionit Policor ne Glllogoc 2013-AG-0966 I dt.15.9.2013 vërtetohet se ne vendin e ngjarjes ne arën e mbjella me misër e I.C.ne fsh.....Komuna G..... është gjetur një gyp prej alumini për ujitje në gjatësi prej 6,10 m, i cili gjendej përfund telave të rrymës elektrike të tensionit të larte në mese të dy shtyllave distance e shtyllave ishte rrethe 65 m, dyshohet se me ate gyp L2.I.C.i lindur ne vitin 1998nga fsh....., Komuna G..... ka prekur ne përçuesit elektrik pas kontaktimit me prokurorin kujdestar të krimeve të renda pasi është konstatua vdekja e L.C2.t në shtëpinë e shendetit ne Glllogoc me urdhëri e prokurorit viktima është dergue ne Obduksion ne institutin e mjekësisë ligjore ne Prishtine. Nga raporti i Autopsisë Departamenti i Mjekësisë Ligjore Prishtine MA13-222 I dt.16.9.2013 vërtetohet se shkaku I vdekjes se L2.I.C.I lindur ne vitin 1998 është pasoj e goditjes nga rryma elektrike. Nga ekspertiza e ekspertit te elektros

inxh.Y.Z.e dt.21.09.2020 vërtetohet; Operatori i rrjetit të furnizimit me energji elektrike bazuar në rregullat mbi shfaqje dhe rikujtim të konsumatorëve në sektorin e energjisë në Kosovë dhe bazuar në standardet dhe normat teknike nuk ka patur lëshime teknike në rrjetin 10kv, ku është aksidentuar i ndjeri L.C2., lartësia e linijes 10 kv ditën kritike nga fotot e vendit të ngjarjes që ndodhen në shkresat e lendes foto nr.1 nuk vërehet se ka pasur përkulje të fijeve përçuese 10 kv, lartësia e lindjes 10 kv në gjendje të rregullt duhet të jete $h + 6,5m$. në $h = 7.5$ m. dhe mbi $h = 7.5$ m., lartësia minimale mbi rrugë 5.8 m., lartësia minimale nga toka në çdo pike jashtë rrugës duhet të jete 5.2 m. bazuar në të dhënat nga standardet e vendeve të ndryshme evropiane dhe botërore lartësia minimale e lejuar për përkuljen e përçuesve të linjës 10 kv nga toka është 5.2 m, në rastet jashtë çdo rrugë, Operatori i rrjetit për furnizim me energji elektrike nuk është përgjegjës për rastin e aksidentit pasi që gjatësia e gypit nga alumini (gypi I ujitjes) është 6.10m, nga kjo në çfarëdo rrethane nëse gypi bartet nga njeriu duke përfshirë edhe gjatësinë deri të krahët e njeriut kalon çdo përmasë të lartësisë së përçuesit të fundit të lindjes 10 kv, në baze të provave të ofruara që ndodhen në shkresat e lendes eksperti ka konstatuar se rasti me fatalitet ka ndodhur aksidentalisht nuk ka lëshime dhe pa rregulluesi teknike të rrjetit 10 kv, të gjetura në ditën kritike. Në sqarimin e ekspertizës së tij eksperti gjatë shqyrtimit në seancën e dt.07.10.2020 lidhur me vendin e incidentit ku ka ndodhur në pronën e paditësve e cila është e rregulluar me masën e komasacionit dhe ka sistemin e ujitjes është sqaruar se me ligjin e energjisë elektrike dhe udhëzimeve administrative të drejta të shfrytëzimit të infrastrukturës për përcjelljen e energjisë elektrike dhe linjave energjetike, trafostacioneve dhe rrugëve për qasje deri të asetet e parkete kompanisë për furnizim me energji elektrike, prona nën përçues të perkete pronarit por edhe aty është e drejta e kompanisë për furnizim me energji elektrike që në çdo kohë të ndërvejoj varësisht nga rastet që ndodhen në teren, është e ndaluar tek linja 10 kv. nga të dy anët nga 3 m, që të mbillen peme drunore të bëhet ndërtim dhe të pengohen zona prej 6 metrave për ndërveprime nga kompania ndërsa të mbjellura vjetore misër, grurë apo diçka tjetër të cilat nuk janë të larta ato lejohen dhe pronari i pa penguar mund të shfrytëzoj token e vet por për derisa është në zonën e sigurisë çdo person qoftë vetëm apo me makineri duhet të ketë kujdes që të mos rrezikoj vetveten pasurinë e vet dhe asetet energjetike . Gjithashtu nga ekspertiza e ekspertit të elektros prof.G.P. e dt.09.12.2020 vërtetohet; bazuar në standardet e sigurisë elektrike për LV/MV/HV në rastin konkret me ushtrimin e aktivitetit (ujitjes së kulturave bujqësore) në këtë zonë ka qene i ndaluar sepse i ndjeri ka ndërhyrë në zonë të sigurisë dhe ka vepruar në kundërshtim edhe me dispozitat e Ligjit nr. 03/L-184 për Energjinë me dispozitën e nenit 30 dhe zonat e sigurisë në paragraf.1 I cili përcakton zonat e sigurisë duhet të vendosen për rreth zonave energjetike ndërsa para.2 përcakton Brenda çfarëdo zone të sigurisë është i ndaluar ose i kufizuar ndërtimi ose ngritja e çfarëdo ndërtese apo godine, prerja e bimëve ose pemëve, ushtrimi i aktiviteteve që mund të paraqesin rrezik ndaj sigurisë ose veprimtarisë së pandërprerë të instalimeve elektrike të sigurisë ose shëndetit jetës dhe pronës të njëjtat ndalesa parasheh edhe udhëzimi administrative nr. 2005/7 mbi rregullat për zonat e sigurisë. Në sqarimin e ekspertizës së tij eksperti gjatë shqyrtimit në seancën e dt.01.02.2021 në pyetjen e parashtruar nga i autorizuari i paditësve se a është e nevojshme të dilet në vendshiqim për të parë gjendjen në mënyrë me konkrete nga se kemi të bëjmë me humbjen e një jete eksperti në skjarim është deklaruar; nuk është e nevojshme dalja në vendshiqim nga se të dhënat relevante janë në shkresat e lendes gjendja reale faktike në momentin e ndodhjes së ngjarjes kritike do të duhej të ishte konstatuar menjëherë në ditën kritike ose në ditët e para pas incidentit me kërkesë të palës së dëmtuar e mos të pritët deri në ngritjen e padisë dhe tani nuk do të ishte relevante të konstatohet çfarëdo ndryshimi të linjës elektrike në periudhën e kaluar prej pesë viteve, në baze të fotografive dhe raportit zyrtar të policisë vërtetohet se i ndjeri –djaloshi ka qene duke punuar në ujitjen e arës e mbajllur me misër nën linjën elektrike që bene pjesë në zonën e sigurisë ku janë të ndaluara veprimtarit që mund të jene të rrezikshme për jetën dhe shëndetin i ndjeri ka qene duke bartur-mbajtur një gyp

te aluminimit ne vendin e ngjarjes me gjatësi prej 6.10 m, e qe se bashku me gjatësinë e te ndjerit kalon dukshëm dhe qenësisht lartasin e sigurisë e qe dëshmojnë qartazi se lartësia e sigurisë se përçuesve elektrik kane qene ne suaza dhe konform te standardeve te Ligjit për Energjinë dhe udhëzimit administrative mbi rregullat e zonave te sigurisë.

Tutje gjykata ka shtuar se ka analizuar dhe vlerësuar mendimin e eksperteve inxh.ielektros Y.Z.dhe Prof.Dr.G.P. i ka aprovuar në tërësi dhe ju dhuroj besimin e plote me që të njëjtit në mënyrë shkencore e profesionale dhe bindëse për gjykatën kane dhëne mendimet e tyre dhe kane arsyetuar në mënyrë të qarte gjate shqyrtimit se Operatori i rrjetit te furnizimit me energji elektrike bazuar ne rregullat mbi shqyejnë dhe rikyqjen e konsumatorëve në sektorin e energjisë në Kosovës dhe bazuar ne standardet dhe normat teknike nuk ka patur lëshime teknike ne rrjetin 10 KV. ku është aksidental i ndjeri L.C2. rasti me fatalitet ka ndodhur aksidentalisht nuk ka lëshime dhe pa rregulluesi teknike të rrjetit 10 KV, në ditën kritike i ndjeri ka qene duke punuar në ujitjen e arës e mbjella me misër nen linjën elektrike qe bene pjese në zonën e sigurisë ku janë të ndaluara veprimtarit që mund të jene te rrezikshme për jetën dhe shëndetin e njeriut sipas dispozitave te e Ligjit nr. 03/L-184 për Energjinë dhe zonat e sigurisë nenit 30 par.1 dhe 2,I ndjeri ka qene duke bartur-mbajtur një gyp të aluminimit në vendin e ngjarjes me gjatësi prej 6.10 m, qe se bashku me gjatësinë e trupit te tij kalon dukshëm dhe qenësisht lartasin e sigurisë e që dëshmojnë qartazi se lartësia e sigurisë së përçuesve elektrik kane qene ne suaza dhe konform te standardeve te Ligjit për Energjinë dhe udhëzimit administrative nr. 2005/7 mbi rregullat per zonat e sigurisë. Po ashtu gjykata pasi qe ka analizuar dhe vlerësuar dëshmitë e dëshmitareve I.S.dhe H.K.punëtor te paditurës me punët dhe detyrat mirëmbajtjen e rrjetit ne teren dhe teknik i prishjes se rrjetit elektrik ne teren i ka aprovuar në tërësi dhe ju dhuroj besimin e plote me qe nga deklaratat e dëshmitareve nuk u vërtetua pretendimi i paditësve se e paditura pas ndodhjes se incidentit ku ka humbur jetën I ndjeri L.C2. familjar i paditësve e paditura ka ndërhyje -intervenua ne rrjetin elektrik 10 kv.

Gjykata e shkalle së parë ka shtuar se për te ekzistua përgjegjësia juridiko- civile e dëmshpërblimit ne mënyrë kumulative duhet të ekzistoj veprimi i kundërligjshëm, ose veprimi kur është i obliguar të veproi, të ekzistoi demi, fajësia dhe përgjegjësia si dhe lidhja kauzale ne mes te veprimit ose mos veprimit dhe shkaktimit te demit. Bazat e pergjgjesise per demin e shkaktuar sipas nenit 136 par.2 dhe nenit 154 te LMD-se për demin nga sendet e rrezikshme ose veprimtarit nga te cilat rrjedh rreziku i shtuar I demit për rrethin përgjigjet pavarësisht nga faji ne baze te përgjegjesisë objektive, por qe duhet doemos te ekzistoj lidhja shkakësore ndërmjet veprimit te demit te shkaktuar nëse kjo lidhje nuk ekziston nuk ka përgjegjësi për demin, barra e te provuarit bje mbi zotëruesin e sendit te rrezikshëm përkatësisht mbi personin qe mirët me veprimtarin e rrezikshme. Rrjedhimisht me provat e administruara gjykata ka vërtetua se ne rastin konkret nuk ka ekzistuar lidhja shkakësore ndërmjet veprimit apo mos veprimit nga e paditura KEDS te rrjetit elektrik 10 KV ne fsh.....ne lagjen C..... Komuna G..... dhe demit të shkaktuar të pretenduar nga paditësit përkatësisht nuk ka ekzistuar lidhja kauzale për çka dhe e paditura KEDS konform nenit 319.1 te LPK-se ka argumentuar pretendimet e saja lidhur me kontestimin e bazës juridike të padisë së paditësve dhe kontestimin e aprovimit të kërkesëpadisë, andaj e paditura ne ketë çështje juridike bazuar ne nenin 136 par.2 dhe nenit 154 te LMD-se për demin nga sendet e rrezikshme ose veprimtarit nga te cilat rrjedh rreziku i shtuar i demit për rrethin nuk kane detyrim ndaj te paditurve te kompensojnë demin e pretenduar si ne kërkesë padi e ne mungese te provave per arguementim te pretendimeve te paditësit gjykata ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit si te pa bazuar si ne piken I te dispozitivit te aktgjykimit.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, i është referuar nenit 136 par.1 dhe 2, 140, 154, 155 dhe 158 të LMD-së. Për shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur duke u mbështetur në nenin 450 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e pjesshme të kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për gjendjen faktike të konstatuara në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, sepse në bazë të provave të administruara gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të pa kontestuar e ka vërtetuar faktin se fatkeqësia me fatalitet, ka ndodhur me datë 15.09.2013, rreth orës 17:30 minuta, në fshatin ne fsh...., Komuna G....., fatkeqësia ka ndodhur kur tani i ndjeri L2.Cakiq me gyp të ujitjes me gjatsi 6.10 m, duke punuar në ujitjen e ares me miser ka prekur largpërçuesin në linjën 10 kv , me ç ‘rast si pasojë e kësaj fatkeqësie ka humbur jetën, djali, vëllai, nipi i këtu paditësve. E paditura e nuk ka përgjegjësi për fatkeqësinë e ndodhur sepse nga dy ekspertizat e elektros është vërtetuare se Operatori i rrjetit te furnizimit me energji elektrike bazuar ne rregullat mbi shkqeyjn dhe rikyqjen e konsumatorëve në sektorin e energjisë ne Kosovës dhe bazuar ne standardet dhe normat teknike nuk ka pasur lëshime teknike ne rrjetin 10kv, ku është aksidentuar i ndjeri L.C2., lartësia e linjës 10 kv ditën kritike nga fotot e vendit te ngjarjes që ndodhen në shkresat e lendes foto nr.1 nuk vërehet se ka pasur përkulje te fijeve përçuese 10 kv, lartësia e lindjes 10 kv ne gjendje te rregullt duhet te jete h +6,5m. ne h.=7.5 m. dhe mbi h=7.5 m., lartësia minimale mbi rruge 5.8 m., lartësia minimale nga toka ne çdo pike jashtë rrugës duhet e jete 5.2 m. bazuar në të dhënat nga standardet e vendeve te ndryshme evropiane dhe botërore lartësia minimale e lejuar për përkuljen e përçuesve të linjës 10 kv nga toka është 5.2 m, në rastet jashtë çdo rruge, Operatori i rrjetit për furnizim me energji elektrike nuk është përgjegjës për rastin e aksidentit pasi që gjatësia e gypit nga alumini (gypi I ujitjes) është 6.10m, nga kjo në çfarëdo rrethane nëse gypi bartet nga njeriu duke përfshirë edhe gjatësinë deri te krahët e njeriut kalon çdo përmasë të lartësisë se përçuesit të fundit te lindjes 10 kv, ne baze te provave te ofruara qe ndodhen ne shkresat e lendes eksperti ka konstatuar se rasti me fatalitet ka ndodhur aksidentalisht nuk ka lëshime dhe pa rregulluesi teknike te rrjetit 10 kv, me rastin e shkaktimit të fatkeqësisë me fatalitet dhe tani i ndjeri Sh.A., me veprimet tij, ka ardhur deri te shkaktimin e kësaj fatkeqësie. Po ashtu gjykata drejte ka vërtetuar faktin se paditësit janë familjarë të ndjerit L.C2., të cilët kanë jetuar së bashku me të ndjerin deri në momentin e vdekjes së tij dhe në këtë kuptim gjykata e shkallës së parë drejt ka vërtetuar gjendjen faktike për faktin se me nenin 321 paragraf 1 dhe 2 të LPK-së, përcaktohet se: “ Nuk ka nevojë të provojë faktet e ditura botërisht e as faktet që i ka vërtetuar gjykata në gjykimet e më hershme, gjykata nuk ka nevojë të provoj as faktet të cilat pala i ka pohuar para gjykatës gjatë procesit gjyqësor ”. Po ashtu me nenin 180 paragraf 1 të LPK-së, përcaktohet se: “ në ankesë nuk mund

të paraqiten fakte të reja dhe propozohen prova të reja përveç se kur ankuesi i jep prova se pa fajin e vetë nuk mund ti paraqes përkatësisht ti propozoj gjerë në shqyrtimin kryesor në gjykatën e shkallës së parë”. Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm. Në këtë rast edhe pse paditësit e kanë pretenduar se ekziston bazën juridike për aprovimin e kërkesëpadisë gjatë shqyrtimit gjyqësor në shkallë të parë të njëjtit me asnjë provë bindëse nuk e kanë argumentuar të kundërtën e pretendimeve nga padia.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale për arsyeje se:

Me e nenit 136 të LMD-së, përcakton se; “Kush I shkakton tjetrit dem ka për detyre ta kompensoi, përveç nëse vërtetohet se dem është shkaktuar pa fajin e tij, ndërsa par.2 parasheh; “Për demin nga sendet ose nga veprimtarit nga të cilat rrjedh rreziku i shtuar i demit për rrethin përgjigjet pavarësisht nga faji”, neni 140 I LMD-se përcakton se; “Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar demin me dashje ose nga pakujdesia”, neni 154 i LMD përcakton se: “Dëmi i shkaktuar lidhur me sendin e rrezikshëm, përkatësisht me veprimtarinë e rrezikshme konsiderohet se rrjedh nga ky send, përkatësisht nga kjo veprimtari, përveç nëse provohet se ato nuk kanë qenë shkak i dëmit”, neni 155 i LMD-se përcakton se: “Për dëmin nga sendi i rrezikshëm përgjigjet zotëruesi i saj, kurse për dëmin nga veprimtaria e rrezikshme përgjigjet personi që merret me të”, ndërsa nenin 158 paragrafi 1 përcakton se: “Zotëruesi lirohet nga përgjegjësia në rast se provohet se dëmi rrjedh nga ndonjë shkak që ka ndodhur jashtë sendit dhe efekti i të cilit nuk ka mundur të parashihet, të mënjanohet ose të evitohet”.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore e duke u bazuar në këtë gjendje faktike Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallë së parë drejt ka aplikuar të drejtën materiale dhe ka vërtetuar se e drejta e paditësve për të kërkuar kompensimin e dëmit ndaj të paditurës nuk është e bazuar sepse paditësit të drejtën e tyre nuk e kanë provuar me asnjë provë se për demin e shkaktuar përgjegjësia bie mbi të paditurën pasi që nga dy ekspertizat e elektros nuk është vërtetuar se si rezultat i lëshimeve të të paditurës ka ardhur deri të shkaktimi i demit në këtë rast, në këtë rast paditësit kanë pasur detyrim ta provojë se dem i shkaktuar është si rezultat i sendit të rrezikshëm apo veprimtarisë së rrezikshme të te paditurës dhe këto fakte nuk i kanë provuar paditësit, ndërsa e paditura e ka provuar se veprimtaria e tyre përkatësisht sendi i tyre nuk ka qenë shkak i demit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.3721/2021, me datë 21.06.2024

Kryetari i kolegjit
Naim Mehulli, d.v